



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde -Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD-NR. 07/2024
PËR GRADAT E ZYRTARËVE KORREKTUES¹

¹ Udhëzim Administrativ MD – Nr. 07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, i aprovuar nga Ministria e Ministrisë së Drejtësisë me datë: 18.07.2024, me Vendim Nr.278/2024 të datës 18.07.2024.

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 53 (paragrafi 2) të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës si dhe në përputhje me nenin 9 (paragrafi 2) të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës të Kosovës (21.06.2024),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
MD-NR. 07/2024
PËR GRADAT E ZYRTARËVE KORREKTUES**

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet procedura dhe kushtet për gradim të zyrtarëve korrektues.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen për të gjithë zyrtarët korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

**KAPITULLI II
GRADAT E ZYRTARËVE KORREKTUES**

**Neni 3
Sistemi i Gradave**

1.Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat si në vijim:

- 1.1. Kadet për Zyrtar Korrektues;
- 1.2. Zyrtar Korrektues;
- 1.3. Mbikëqyrës;
- 1.4. Mbikëqyrës i Lartë;

1.5. Udhëheqës i Njesisë.

Neni 4

Identifikimi dhe planifikimi i vendeve të lira të punës

1. Identifikimi i vendeve të lira të punës për personelin e uniformuar bëhet nga Institucionet Korrektuese dhe kërkesa përcjellët në Njësine e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

2. Planifikimi afatshkurtër dhe afatgjatë bëhet nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe aprohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Drejtori i Përgjithshëm).

Neni 5

Kadet për Zyrtar Korrektues

Gradën Kadet për Zyrtar Korrektues e merr kandidati i cili ka përfunduar me sukses procedurat e rekrutimit dhe ka nënshkruar kontratën për themelimin e marrëdhënies së punës si Kadet për Zyrtar Korrektues me Shërbimin Korrektues të Kosovës në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 6

Zyrtari Korrektues

Kandidati i cili ka përfunduar me sukses trajnimin bazik në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe ka nënshkruar Akt Emërimit për themelimin e marrëdhënies së punës si zyrtar korrektues me Shërbimin Korrektues të Kosovës e merr Gradën I.

Neni 7

Konkursi për Gradim

1. Avancimi për Gradën II, III dhe IV bëhet përmes konkursit të brendshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

2. Konkursi për avancim në gradat nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:

2.1. emrin e institucionit;

2.2. pozitën dhe përshkrimin e vendit të punës;

2.3. koeficientin e gradës;

2.4. dokumentacionin e nevojshëm për aplikim;

2.5. testet të cilave do t'u nënshtrohet kandidati;

2.6. vendin dhe adresën e saktë ku merren dhe dorëzohen aplikacionet;

2.7. afatin për pranim-dorëzim të aplikacioneve.

Neni 8

Kriteret për Gradën Mbikëqyrës

1.Kandidatët që aplikojnë për Mbikëqyrës, përkatësisht për avancim në Gradën II përveç kushteve të përgjithshme që parashihen me legjislacionin në fuqi duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- 1.1.të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në Gradën I;
- 1.2.të ketë përgatitje universitare;
- 1.3.dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën *arrinë pritshmëritë*;
- 1.4. të mos ketë masë të shqiptuar disiplinore aktive;
- 1.5. dëshmi nga gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij.

Neni 9

Kriteret për Gradën Mbikëqyrës i Lartë

1.Kandidatët që aplikojnë për Mbikëqyrës i Lartë, përkatësisht për avancim në gradën III përveç kushteve të përgjithshme që parashihen me legjislacionin në fuqi, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

- 1.1.të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në gradën I, apo tri (3) vite përvojë pune në gradën II;
- 1.2. të ketë përgatitje universitare;
- 1.3. dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën *arrinë pritshmëritë*;
- 1.4. të mos ketë masë të shqiptuar disiplinore aktive;
- 1.5. dëshmi nga Gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij.

Neni 10

Kriteret për Gradën Udhëheqës

1. Kandidatët që aplikojnë për Udhëheqës, përkatësisht për avancim në gradën IV përveç kushteve të përgjithshme që parashihen me legjislacionin në fuqi, duhet t'i plotësojnë kriteret e parapara si në vijim:

- 1.1.të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë punë në gradën I – Zyrtar Korrektues apo së paku pesë (5) vite përvojë pune në gradën II – Mbikëqyrës, apo së paku tre (3) vite përvojë pune në gradën III – Mbikëqyrës i Lartë;
- 1.2.të ketë përgatitje universitare;
- 1.3.dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën *arrinë pritshmëritë*;

1.4.të mos ketë masë të shqiptuar disiplinore aktive;

1.5.dëshmi nga gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij.

Neni 11

Komisioni për procesin e gradimit

1.Komisioni themelohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm.

2.Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë nga zyrtarët e Shërbimit Korrektues.

3.Kryesuesi dhe njëri anëtarë i Komisionit duhet të ketë së paku një (1) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit. Anëtari i tretë i Komisionit duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

4.Komisioni për procesin e gradimit shqyrton dhe vlerëson aplikacionet e pranuar për gradim.

5.Njësia e Burimeve Njerëzore mbështetë punën e komisionit për gradim.

Neni 12

Informimi për mbajtjen e testeve

1. Informimi i kandidatëve për çdo fazë të testimit bëhet nga njësia e Burimeve Njerëzore, së paku pesë (5) ditë para mbajtjes së testimit.

2. Lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe në tabelën e shpalljeve të drejtorive të institucioneve përkatëse korrektuese.

Neni 13

Procedura e testimit

1. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara për gradën përkatëse do t'i nënshtrohen procedurave të testimit.

2. Procedura e testimit mbahet sipas radhitjes vijuese:

2.1.testi me shkrim;

2.2.intervista me gojë.

Neni 14

Testi me shkrim

1.Testi me shkrim përpilohet në gjuhët zyrtare dhe përbëhet nga pesëdhjetë (50) pyetje. Secila përgjigje e saktë ka vlerën e dy (2) poenave.

2.Testi hartohet për të testuar njohuritë në fushën e legjislacionit penal, ekzekutimin e

sanksioneve penale, Institucioneve Korrektuese dhe shkathtësitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimit.

3.Rezultati minimal i kërkuar për të kaluar me sukses testin është shtatëdhjetë (70) poena të testit.

4. Koha e testimit zgjatë një (1) orë e tridhjetë (30) minuta.

Neni 15

Intervista me gojë

Në intervistë kandidatëve do t'u parashtrohen pyetje të standardizuara duke përfshirë aftësitë komunikuese, të udhëheqjes, vendimmarrjes dhe njohuritë profesionale.

Neni 16

Rezultati përfundimtar

Kandidati i suksesshëm konsiderohet kandidati i cili në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka arritur më së shumti poena, por jo më pak se gjashtëdhjetë (60) nga njëqind (100) poenat e caktuara.

Neni 17

Shpallja e rezultateve

1.Njësia e Burimeve Njerëzore është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të çdo faze të testimit në faqen zyrtare të Shërbimit Korrektues si dhe në tabelën e shpalljeve në Institucionet Korrektuese. Njoftimi përmban të dhënat e kandidatëve si dhe pikët e fituara gjatë procedurës së përzgjedhjes.

2.Rezultatet publikohen brenda shtatë (7) ditëve pas përfundimit të procedurës së rekrutimit të kandidatëve të suksesshëm.

3.Akt Emërimi me zyrtarin e graduar nënshkruhet dhjetë (10) ditë para fillimit të trajnimit.

Neni 18

Ankesa

Pas publikimit të listës përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, kandidati i pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë tek organi kompetent.

KAPITULLI III

PERIUDHA PROVUESE

Neni 19

Dhënia e gradës dhe caktimi në detyrë

1.Pas përfundimit me sukses të trajnimit për gradën përkatëse, zyrtari caktohet në detyrë në

përputhje me gradën e fituar.

2.Zyrtari i graduar i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët.

3.Gjatë periudhës provuese, zyrtari i graduar kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

Neni 20

Degradimi

1.Me rastin e identifikimit të mangësive të zyrtarit të graduar nga udhëheqësi i drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive, njoftohet me shkrim Drejtori i Institucionit. Drejtori i Institucionit pas vlerësimit të raportit mund të jap një afat shtesë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive.

2.Në rast të mos përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive edhe pas afatit të caktuar nga Drejtori i Institucionit, zyrtari përkatës degradohet.

3. Ulja në gradë bëhet në gradën të cilën zyrtari e ka pasur para gradimit.

4. Kundër Vendimit për ulje në gradë, zyrtari mund t'i drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Neni 21

Caktimi i Zëvendësuesit

1.Kur nevojat e shërbimit kërkojnë plotësimin e një vendi të lirë, atëherë me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm, përkohësisht caktohet zëvendësuesi.

2.Zëvendësuesi duhet t'i plotësoj kriteret e pozitës për të cilën caktohet dhe i gëzon të gjitha të drejtat dhe beneficionet që i kanë takuar zyrtarit i cili më herët ka qenë në atë pozitë. Zëvendësuesi nuk mund të caktohet për një periudhë më të gjatë se një (1) vit.

Neni 22

Certifikata e gjendjes penale

Njësia e Burimeve Njerëzore për secilin kandidat që i nënshtrohet procedurës së gradimit siguron certifikatën e gjendjes penale të kandidatit nga organet kompetente me të cilën vërtetohet e kaluara penale e kandidatit.

Neni 23

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 02/2022 për gradat e zyrtarëve korrektues, kontrollimi i së kaluarës së tyre, periudha provuese dhe promovimi.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

18.07/2024